

VENDIM
Nr.510, datë 30.6.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“URA E GAJDARIT - RRAP” (RRUGA HYRËSE, SARANDË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura e Gajdarit - Rrap” (rruga hyrëse, Sarandë).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 049 (një mijë e dyzet e nëntë) m², tokë truall, me vlerë 12 588 000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, objekte, me sipërfaqe 780.5 (shtatëqind e tetëdhjetë pikë pesë) m², me vlerë 14 262 761 (katërmëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 475 000 (katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokë truall dhe objekte (dyqan, objekte banimi, karabina) është 26 850 761 (njëzet e gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë, e cila do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.6.2010 dhe të përfundojë më 15.9.2010.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë të përditësuar, brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pasuria në emër të bashkëpronarëve Agim Dule, Avdul Dule dhe Musa Musai të kompensohet, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit të pasurisë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe pasi këta bashkëpronarë të kenë paraqitur dokumentin hipotekor të pronës. Ndërsa pasuritë në emër të shtetasve Thanasi Vaho Naci, Xhemal Resul Cepe dhe Sheko Mine Xhuvani do të kompensohen pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit të pasurive që ata disponojnë dhe pasi ata të kenë përfunduar regjistrimin e pasurive në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të kenë paraqitur dokumentin hipotekor të pronës.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7 e 8 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

10. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Sarandë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “URA E GAJDARIT RRAP-SARANDË”

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kad.	Nr. i pasurisë	Vërtetim hipotekor	Lloji i pasurisë					Sip. objekti m ²	Vlera totale lekë	Shënime
							Truall			Objekte				
							Sip.m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë			
1	Agim Avdul Musa		Dule Dule Musai	1722			36	12000	432000	dyqan	3775695	194	4207695	Proces.rregj.fillestar konf.Zrpp
2	Thanas	Vaho	Naci	8642	25/98		195	12000	2340000	banesë	6151398	420	8491398	Prces legalizimi-konf
3	Sheko	Mine	Xhuvani	8642	25/99		110	12000	1320000	banesë	3632855	107.5	4952855	Prces legalizimi-konf
4	Xhemal	Resul	Cepe	8642	25/97		220	12000	2640000	karab.1k	702813	59	3342813	Prces legalizimi-konf
5	Simon	Josif	Cipa	8642		138	200	12000	2400000				2400000	Konf.Zrpp (vërt.hip)
6	Ilmir	Subi	Majka	8642		1	99	12000	1188000				1188000	Konf.Zrpp (vërt.hip)
7	Veli	Fiko	Hasani	8642		14	107	12000	1284000				1284000	Konf.Zrpp (vërt.hip)
8	Artur	Baftjar	Myftari	1722	1814/1		82	12000	984000				984000	Konf.Zrpp (cert.prone)
	Totali						1049		12588000		14262761	780.5	26850761	